

Data: 01.04.2019

Ref.: 539/190

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 64-të, të mbajtur më 08 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.324/19H, datë 25.02.2019 e Universitetit "Kadri Zeka", si e bazuar.
- II. Anulohet tërheqja e akreditimit sipas pikës I (një) të vendimit të KSHC-së Nr.139/19D, datë 05.02.2019 për programet e studimit:
 - Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS;
 - Parashkollor, BA, 240, ECTS, dhe
 - Fillor, BA, 240 ECTS.
- III. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.139/19D, datë 05.02.2019 mbetet në fuqi.

Arsyetimi

Me qëllim të plotësimit të kriterëve formale për staf akademik sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), KSHC bazuar në pikën 2.1. Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018) dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), në mbledhjen e 63-të, mbajtur më 27 shkurt 2019, vendosi që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të iu lejohet/pranohet riorganizimi i stafit akademik bartës të programeve, të deklaruar në afatin kohor të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018).

KSHC me vendim Nr.139/19H, datë 05.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve si me poshtë: Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS; Marketing, BSc, 180 ECTS; Parashkollor, BA, 240, ECTS, dhe Fillor, BA, 240 ECTS.


Universiteti "Kadri Zeka", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KShC-së Nr.139/19D, datë 05.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë 25 shkurt 2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Përmes kësaj ankesa, Universiteti ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth staf akademik për programin e studimit: Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS; Parashkollor, BA, 240, ECTS, dhe Fillor, BA, 240 ECTS, i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendim të KSHC-së Nr.139/19D, datë 05.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 64-të të KShC-së, të mbajtur me 08 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e cekura në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij vendimi i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe inicimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit "Kadri Zeka"
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

